



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 102

2003

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr.4033 datë 10.12.2003	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare..... 4369
Vendim i GJK nr.35, datë 12.12.2003	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.2962, datë 14.9.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.138, datë 1.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1013, datë 28.4.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese..... 4370
Udhëzim i MF nr.18 datë 19.11.2003	Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore..... 4373
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr.100, datë 10.12.2003	Rregullore për marrëdhëniet e bankës me personat e lidhur me të..... 4393
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr.101, datë 10.12.2003	Për disa ndryshime në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendim nr.64, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 4397
Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të BSH nr.102, datë 10.12.2003	Për disa ndryshime në rregulloren “Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave”, miratuar me vendimin nr.6, datë 29.1.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë..... 4397
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasve Bajron Allamani dhe Esmeralda Allamani..... 4398

DEKRET
Nr.4033, datë 10.12.2003

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|---|--|
| 1. Arta Qani Sula | 36.Sahmet Eduart Demiri |
| 2. Laura Ilir Sula | 37.Anjeza Eduart Demiri |
| 3. Arnela (Armela) Rami Troplini (Çepele) | 38.Mimoza Adem Demiri (Arap) |
| 4.Luan Ymer Karbunara | 39.Emilio Eduart Demiri |
| 5. Claudia Luan Karbunara | 40.Arben Reshat Resmja |
| 6. Henry Luan Karbunara | 41.Gisela Arben Resmja |
| 7. Tatiana Vasip Karbunara (Dizdari) | 42.Arjeta Hasan Resmja (Bega) |
| 8. Fabardh Hajredin Kasa (Kaso) | 43.Anila Sali Sevdaraj (Kurti) |
| 9. Artan Broz Pali | 44.Joana Fiqiri Sevdaraj |
| 10.Sonilda Dashamir Gashi (Shtiza) | 45.Frida Fiqiri Sevdaraj |
| 11.Richard Ermal Gashi | 46.Çlirim Dervish Avdo |
| 12.Greta Thoma Nolke (Kondi) | 47.Kristulla Jano Cani (Vasili) |
| 13.Arjon Ibrahim Beberi | 48.Romina Besim Cani |
| 14.Ezmeralda Arjan Berberi | 49.Klara Besim Cani |
| 15.Emanuel Arjan Berberi | 50.Margret Dhosi Çeku |
| 16.Erjana Arjan Berberi | 51.Fatbardha Myrte Ulbrich (Aliçkaj) |
| 17.Majlinda Haqif Berberi (Lleshi) | 52.Mehmet Ali Mehmeti |
| 18.Uran Reshat Konçi | 53.Skerdi Vezir Hoxha |
| 19.Armando Apostol Gjata | 54.Fatmir Sulejman Beka |
| 20.Spiro Qimo Nikoli | 55.Dorina Ali Leitner (Mara) |
| 21.Oriola Vangjel Nikoli (Tona) | 56.Orest Vasil Konomi |
| 22.Gazmend Ramazan Toska | 57.Jessica Orest Konomi |
| 23.Suend Gazmend Toska | 58.Nevila Shyqyri Konomi (Hafizi) |
| 24.Abbey Gazmend Toska | 59.Rudina Pandeli Stasi (Lala) |
| 25.Suzana Enver Toska (Disha) | 60.Lorenz Ardian Stasi |
| 26.Margarita Jani Fartaczek (Buda) | 61.Laura Llambrani Ardian Stasi |
| 27.Kristaq Vangjel Duka | 62.Remzi Ruzhdi Hyseni |
| 28.Lefter Vangjel Duka | 63.Inida Arben Grewe (Çela) |
| 29.Bukurie Kurt Malecek (Memaçi) | 64.Gafur Bejdo Karamani |
| 30.Valbona Fuat Xhano-Klingspor | 65.Eda Gafur Karamani |
| 31.Servet Ramadan Orhani | 66.Christel Artina Gafur Karamani |
| 32.Samet Servet Orhani | 67.Esmerina Esat Karamani (Reci) |
| 33.Shpresa Bajram Asimi | 68.Muharrem Mezan Selfo |
| 34.Daniela Servet Orhani | 69.Enkelejda Buser Kallienke (Jazexhi) |
| 35.Eduart Isuf Demiri | 70.Fetan Fahredin Bllaca |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.35, datë 12.12.2003

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 30.10.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.36 Akti që i përket:

KËRKUES: ULUSI BICI

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

IBRAHIM SPAJA, përfaqësuar nga avokat Novruz Hasanaj, me prokurë.

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË, në mungesë.

KOMUNA FARKË, përfaqësuar nga juristja Valbona Legisi, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.2962, datë 14.9.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.138, datë 1.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1013, datë 28.4.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore janë rezultat i zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, i cili konsiston në këto drejtime kryesore:

Së pari: Procesi gjyqësor nuk është zhvilluar nga një gjykatë kompetente. Çështja është gjykuar në gjykatën e shkallës së parë nga një gjyqtar i vetëm dhe jo me trup gjykues. Padia ka pasur për objekt kundërshtimin e një akti administrativ me vlerën e 11 mijë m² truall, që kalon vlerën 5 milionë lekë. Janë shkelur kërkesat e nenit 35 shkronja “e” të Kodit të Procedurës Civile.

Së dyti: Gjykata ka injoruar një ndër hallkat e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, hetimin gjyqësor. Gjykata e shkallës së parë, pasi ka hapur seancën, është mjaftuar vetëm me dëgjimin e palëve. Ajo ka përfunduar gjykimin dhe e ka zgjidhur çështjen në themel pa zhvilluar hetimin gjyqësor dhe pa administruar asnjë provë, duke shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.2962, datë 14.9.2001, në çështjen me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë së aktit të marrjes së tokës në pronësi dhe regjistrimin nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të sipërfaqes së tokës 5000 m²”, ka rrëzuar padinë e ngritur nga 12 shtetas, midis të cilëve figuron dhe kërkuesi.

Ky vendim është lënë në fuqi nga gjykata e apelit, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit.

Pretendimi kryesor i kërkuesit, të cilin Gjykata Kushtetuese e çmon të rëndësishëm për ta analizuar, lidhet me konceptin e gjykatës kompetente. Në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është parashikuar gjykata e caktuar me ligj, si një ndër

elementet që përcakton zhvillimin e rregullt të një procesi gjyqësor. Në legjislacionin tonë procedural civil dhe penal ky koncept kushtetues është konkretizuar në dispozita konkrete.

Gjykata Kushtetuese çmon se mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në momentin e paraqitjes së padisë, e disa rregullave procedurale që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi ka sjellë cenimin e një elementi thelbësor kushtetues, që lidhet me gjykatën kompetente.

Çështjen në shqyrtim gjykata e shkallës së parë e ka gjykuar me një gjyqtar të vetëm. Neni 35 i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar, si një kusht thelbësor për përbërjen e rregullt të trupit gjykues, vlerën në lekë të aktit administrativ që kundërshtohet. Përcaktimi i vlerës së padisë, në rastet e kundërshtimit të paligjshmërisë së akteve administrative, përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar mbi gjykatën kompetente.

Gjykata e shkallës së parë, kur ka pranuar për shqyrtim kërkesëpadinë, nuk e ka vlerësuar këtë aspekt të rëndësishëm procedural, i cili bëhet determinant në ecurinë e mëtejshme të procesit. Verifikimi i kompetencës, i juridiksionit apo përbërjes së rregullt të trupit gjykues për gjykimin e një çështjeje, si momente thelbësore të një procesi ligjor, të cilat kanë gjetur pasqyrim në pjesë të veçanta të Kodit të Procedurës Civile, mbeten si një detyrim për t'u zgjidhur nga vetë gjykata dhe që nuk lidhen domosdoshmërisht me disponibilitetin e palëve në gjykim.

Në këto kushte, Gjykata Kushtetuese vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke shqyrtuar një padi që kishte për objekt kundërshtimin e aktit administrativ me një vlerë të konsiderueshme, por edhe të matshme objektivisht, ka lejuar shkeljen e një prej elementeve esenciale të procesit të rregullt ligjor, që ka të bëjë me gjykatën kompetente.

Kjo shkelje nuk është riparuar as nga ana e gjykatës së apelit dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, shkelje, e cila e bën të gjithë procesin gjyqësor të parregullt nga pikëpamja kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese, duke e analizuar procesin vetëm në drejtim të konceptit kushtetues të përbërjes së trupit gjykues dhe të gjykatës kompetente, çmon se është e mjaftueshme për të konkluduar se të tre vendimet gjyqësore duhet të shfuqizohen si antikushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja “f” dhe 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën të vendimeve nr.2962, datë 14.9.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.138, datë 1.2.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.1013, datë 28.4.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Çështja i dërgohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Në çështjen me kërkuar Ulusi Bici, nuk jemi dakord me konkluzionet e shumicës. Kërkesa duhej të ishte rrëzuar si e pabazuar, pasi mendojmë se të gjitha pretendimet e paraqitura pranë Gjykatës Kushtetuese nuk kanë qenë të tilla që ta bënin procesin e zhvilluar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të parregullt në kuptimin kushtetues.

Në fakt, shumica ka pranuar si shkak për shfuqizimin e vendimit nr.2962, datë 14.9.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe për pasojë edhe atë të gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë, pretendimin kryesor të kërkuarit lidhur me përcaktimin e gjykatës kompetente, pasi sipas tij, padia ka pasur për objekt kundërshtimin e një akti administrativ me vlerën e 11 mijë m² tokë bujqësore, gjë që sipas kërkuarit e kalon shumë prej 10 milionë lekë. Për këtë arsye, sipas nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, në shkallën e parë, çështja duhej gjykuar me trup gjykues dhe jo me gjyqtar të vetëm.

Ne vlerësojmë se edhe ky pretendim duhej rrëzuar për këto arsye:

Vërtetohet se fillimisht kërkesëpadia e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur si objekt pavlefshmërinë e veprimit juridik, pavarësisht se kërkuarit nuk kanë pasur dhe nuk pretendojnë të kenë asnjë titull pronësie mbi tokën ku kanë ndërtuar shtëpitë. Vetëm pas disa seancave ata ndryshuan objektin e padisë, duke kërkuar kundërshtimin e aktit administrativ që bën pronar mbi këtë tokë zotin Spaja.

Sipas certifikatës mbi pronësinë, vërtetohet se objekt konflikti është një sipërfaqe toke arë prej 5 mijë m² dhe jo 11 mijë m². Shifra prej 5 mijë m² theksohet edhe nga vetë kërkuarit në kërkesëpadinë e paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Mbi këtë bazë, pavarësisht se nuk përmendet në procesverbalin e seancave gjyqësore, rezulton që në seancën përgatitore, në kohën e ndryshimit të objektit të padisë, gjyqtarja i ka pyetur palët mbi vlerën e këtij objekti, për të vendosur lidhur me kompetencën. Pala e interesuar shpjegoi (dhe kjo nuk u kundërshtua nga pala kërkuuese) që në atë kohë, të dyja palët ranë dakord që vlera e tokës në fjalë nuk i kalonte 10 milionë lekë, pasi bëhej fjalë për tokë arë, kodrinore, larg rrugës automobilistike dhe pa ndonjë vlerë të veçantë. Madje u paraqitën edhe disa kontrata shitjeje, përmes të cilave rezulton që çmimi i shitjes së saj në atë kohë ka qenë tepër i ulët (rreth 1 mijë lekë m²).

Rezulton se pretendimi në fjalë, mbi përcaktimin jo drejt të gjykatës kompetente në funksion të vlerës së padisë, nuk është ngritur as në ankimin e bërë në gjykatën e apelit dhe as në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Pra, kërkuari nuk i ka ezauruar vetë mjetet ligjore për ngritjen e këtij pretendimi konkret në Gjykatën Kushtetuese edhe në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Rezulton se në ankim dhe në rekurs janë ngritur pretendime krejt të tjera. Për këtë arsye, mendojmë se në interpretim edhe të nenit 459 të Kodit të Procedurës Civile një pretendim i tillë bie në dekadencë.

Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, në çështjen “Cardot” kundër “Francës”, ka theksuar ndër të tjera se “... Padyshim që neni 26 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut ... nuk kërkon vetëm që t’u drejtohem gjykatave kombëtare kompetente të ushtrojnë të drejtën e rekursit për të goditur një vendim të dhënë, por ai na detyron po ashtu, parimisht, që të ngremë përpara po këtyre gjykatave, të paktën, në thelbin e tyre dhe në format e në afatet e përcaktuara nga e drejta e brendshme, pretendimet që ne kemi ndërmend të formulojmë ...”.

Tiranë, më 12.12.2003

Anëtarë: Gj. Sauli, K. Puto, Xh. Zaganjori, P. Plloçi

UDHËZIM **Nr.18, datë 19.11.2003**

PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën

e Shqipërisë”, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Regjistrimi në organin tatimor

Procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin do të jenë ato të përcaktuara në udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 11.2.2002 “Për procedurat tatimore”.

Personat përgjegjës për pagimin e kontributeve duhet të regjistrohen në organin tatimor brenda 15 ditëve nga çasti kur lind detyrimi për të paguar kontributin. Për këtë:

- punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisen nga organi tatimor me numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i);

- punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar duhet të pajisen në Institutin e Sigurimeve Shoqërore me një listë me numrat e sigurimit shoqëror (NSSH) për të gjithë personat për të cilët paguajnë kontribute (d.m.th. për veten e tyre, për punëmarrësit dhe punëtorët e papaguar të familjes); Kjo listë duhet të dorëzohet pranë organit tatimor çdo tremujor, sipas formularit "Pasqyra e sigurimeve shoqërore, sigurimeve shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat të mbajtura në burim", që paraqitet në shtojcën 4 të këtij udhëzimi.

- punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar me punonjës të papaguar të familjes duhet të azhurnojnë listën e personave për të cilët detyrohen të paguajnë kontributet, sa herë që lista e paraqitur në shtojcën 4 dorëzohet në organin tatimor, pavarësisht nga koha e bërjes së deklaratës, duke paraqitur të dhënat e personave të rinj që fillojnë punë apo lënë vendin e punës, sipas formularit “Pasqyra e të punësuarve rrishtazi dhe të larguarve”, që paraqitet në shtojcën 6 të këtij udhëzimi.

Personat përgjegjës për pagimin e kontributeve duhet të kenë një kontratë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore përpara marrjes së NIPT-it.

Personat përgjegjës për pagimin e kontributeve duhet të deklarojnë statusin sipas të cilit është i detyruar në momentin e regjistrimit ose kur i kërkohet një gjë e tillë nga organi tatimor, ku statusi i mundshëm është:

- punëdhënësi;
- i vetëpunësuar (i vetëm);
- i vetëpunësuar me punëmarrës;
- i vetëpunësuar pa punëmarrës me punëtorë të papaguar të familjes;
- i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punëtorë të papaguar të familjes.

Kur një person, që është subjekt i pagesës së kontributeve, ndryshon statusin (p.sh. nga i vetëpunësuar pa personel në punëdhënësi ose anasjelltas), ai është i detyruar të njoftojë me shkrim organin tatimor brenda 15 ditëve nga momenti i ndryshimit.

Kur veprimtaria ekonomike e një personi të vetëpunësuar ndërpritet, personi i vetëpunësuar duhet të njoftojë menjëherë me shkrim degën e tatimeve që ka lëshuar NIPT-in për ndërprerjen e aktivitetit. Gjithashtu, personi i vetëpunësuar duhet të njoftojë menjëherë degën e tatimeve, me shkrim, në rast të rifillimit të aktivitetit. Nëse nuk e bën një gjë të tillë, atij do t'i refuzohet çdo zbritje në masën e kontributeve për t'u paguar, të cilat të kërkohen në bazë të paragrafit 2 më poshtë.

2. Llogaritja e kontributeve për punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar

a) Llogaritja nga punëdhënësit për punëmarrësit me kohë të plotë

Paga bruto minimale dhe maksimale, për qëllimet e llogaritjes së kontributeve për t'u paguar, përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar).

Kontributet (qoftë të punëmarrësit apo punëdhënësit) llogariten për çdo punëmarrës individual. Llogaritja mbështetet në shumën e pagës bruto mbi pagën minimale mujore deri në kufirin mujor maksimal si më poshtë:

Të ardhurat mujore bruto të punonjësit:	Kontributi i llogaritur:
Deri në minimumin e pagës mujore	Paga mujore minimale(sipas vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës) x tarifa e aplikueshme
Më shumë se paga minimale mujore, por	Të ardhurat mujore bruto x tarifa e aplikueshme

më pak se paga maksimale	
Më shumë se paga mujore maksimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës	Paga mujore maksimale (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave përkatës) x tarifa e aplikueshme

Nëse një punëmarrës ka më shumë se një punësim, çdo punëdhënës duhet të bëjë llogaritjen e kontributeve si më sipër. Nëse kjo rezulton me pagesë më tepër (se kufiri mujor maksimal), organi tatimor do të njoftojë institutet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në bazë vjetore. Pastaj kontributet e paguara tepër do t'i rimbursohen punëmarrësit përkatës apo punëdhënësve përkatës nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor.

b) Llogaritja për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar (përfshirë personat e vetëpunësuar që punësojnë persona të tjerë) dhe punëtorët e papaguar të familjes llogariten si një përqindje e pagës mujore minimale. Përqindjet përkatëse jepen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001 "Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, (i ndryshuar).

Në rastet kur kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes llogariten si përqindje e pagës mujore minimale dhe veprimtaria ekonomike fillon, përfundon ose ndërpritet për një periudhë prej së paku një muaj të plotë kalendarik gjatë një periudhe deklarimi, dhe fillimi, mbyllja ose ndërprerja e veprimtarisë ekonomike i është njoftuar degës së tatimeve me shkrim, shuma e kontributeve për t'u paguar do të llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

shuma për t'u paguar për periudhën e deklarimit x (A / B), ku:

A = numri i muajve të plotë ose të pjesshëm brenda periudhës së deklarimit, gjatë së cilës është kryer veprimtaria ekonomike;

B = numri i muajve të plotë gjatë periudhës së deklarimit.

c) Llogaritja nga punëdhënësit për punëmarrësit me kohë të pjesshme

Për qëllimet e llogaritjes së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, masa e kontributit për t'u paguar nga punëmarrësit me kohë të pjesshme përcaktohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001.

d) Të përgjithshme

Në rastet kur kontributi i llogaritur rezulton me presje dhjetore, atëherë shuma e rezultuar rrumbullakoset në zbritje në vlerën më të afërt në lekë.

3. Forma e deklarimit dhe procedurat e dorëzimit

a) Deklarimi i dokumenteve në letër

Deklarimet e kërkuara duhet të bëhen në formularë dhe pasqyra deklarimi standarde, që paraqiten në shtojcën 1 deri 5 dhe në shtojcën 7 të këtij udhëzimi, në përputhje me shënimet që shoqërojnë këta formularë dhe pasqyra, të cilat do të vihen në dispozicion nga organi tatimor. Këta formularë dhe pasqyra janë:

- Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve shoqërore E-SIG011/a.

- Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve shëndetësore E-SIG012/a.

- Pasqyra e kontributeve për t'u paguar E-SIG025/a.

- Pasqyra e përfitimeve të dhëna E-SIG026/a (nëse rasti është i tillë—pra janë dhënë përfitime).

- Pasqyra e të punësuarve të rinj dhe e të larguarve E-SIG027/a (nëse rasti është i tillë – pra ka të punësuar të rinj ose të larguar).

Formulari i dorëzimit të të dhënave E-SIG046/a.

Dy deklaratat duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë në bankë, bashkë me deklaratën për pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale E-TAP010/a.

Shtojcat duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë në degën e tatimeve, së bashku me formularin dhe dorëzimin e të dhënave E-SIG046/a.

Nëse për periudhën e deklarimit nuk ekzistojnë kontribute për t'u paguar, duhet të depozitohet një deklaratë "zero".

Të gjitha deklarimet dhe pasqyrat duhet të plotësohen në përputhje me shënimet për deklaratat dhe pasqyrat dhe këto shënime dhe pasqyra konsiderohen si pjesë e këtij udhëzimi dhe kanë fuqi ligjore.

b) Deklaratat elektronike

Një person, që është i detyruar të paguajë kontributet, mund të zgjedhë për të dorëzuar në format elektronik të dhënat e deklarimit që lidhen me kontributet për t'u paguar drejtpërdrejt në degën e tatimeve të përcaktuara nga DPT-së, pasqyrën e kontributeve për t'u paguar E-SIG025/a; pasqyrën e përfitimeve të shënuara në formularin E-SIG026/a dhe pasqyrën e të punësuarve rishtazi dhe të larguarve E-SIG027/a.

Personat që lejohen të deklarojnë në këtë mënyrë duhet të marrin paraprakisht miratimin nga DPT-ja dhe ata duhet të përmbushin çdo kërkesë të DPT-së, që lidhet me transferimin e të dhënave dhe dorëzimin e deklaratës.

Kërkesa për të dorëzuar të dhënat elektronike, formulari E-SIG086/a dhe kushtet për dorëzimin e të dhënave elektronike janë të përcaktuara në shtojcën 6 të këtij udhëzimi.

Formulari për dorëzimin e të dhënave E-SIG046/a jepet në shtojcën 7 të këtij udhëzimi dhe duhet të shoqërojë dorëzimin e çdo të dhëne elektronike.

Edhe në rastet kur dorëzimi i të dhënave elektronike miratohet, formulari i deklarimit dhe i pagesës së sigurimeve shoqërore E-SIG011/a dhe formulari i deklarimit dhe i pagesës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore E-SIG012/a duhet të dorëzohet në të njëjtën kohë në bankë, së bashku me formularin e deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale E-TAP010/a.

Të dhënat e dorëzuara në format elektronik, që lidhen me punëmarrësit, duhet të përfshijnë gjithashtu informacionin për pagesat e tatimit mbi të ardhurat të mbajtura në burim që kërkohet sipas pasqyrave në letër.

Nëse për periudhën e deklarimit nuk ekzistojnë kontribute për t'u paguar, duhet të depozitohet një deklaratë 'zero'.

4. Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve

Afatet e deklarimit dhe pagesës janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë dhe përcaktohet në nenin 10 dhe 11 të ligjit. Deklaratat paraqiten dhe kontributet paguhën në afatet e mëposhtme:

Personi që detyrohet të paguajë	Kontributet	Shpeshtësia e deklarimit dhe pagesës	Afati për deklarimin dhe pagesën
Punëdhënësi	Kontributet e punëmarrësve që mbahen nga pagat Kontributet e punëdhënësve	Mujore	Jo më vonë se data 15 e muajit vijues
I vetëpunësuar	Kontributet personale Kontributet për punëtorët e papaguar të familjes	Tremujore	Jo më vonë se datat 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor

Deklarimet janë të kombinuara me formularët e pagesës dhe duhet të dorëzohen në bankë në momentin e pagesës.

Data e dorëzimit është data kur dokumentet mbërrijnë në bankë.

Kur dita e 15-të e muajit ose dita e fundit e tremujorit qëllon në një ditë kur bankat janë të mbyllura, data e pagesës do të jetë dita e fundit e punës përpara datës së depozitimit të përcaktuar më lart.

Afatet e dorëzimit të të dhënave në formë elektronike janë të njëjta si dhe ato për deklarimet në letër.

5. Vendi i pagesës

Kontributet duhet të paguhën në filialet e bankave të cilat kanë kontrata agjentësh me organin tatimor, Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve Shëndetësore. Këto kontrata përcaktojnë mekanizmin e pranimit dhe transferimit të pagesës, kushtet që duhet të përmbushen dhe procedurat për raportimin, si dhe të dhënat për pagesën e bërë.

Pagesa në valutë do të konvertohet në lekë, sipas kursit të këmbimit të botuar nga Banka e Shqipërisë për atë ditë që është bërë pagesa.

6. Rimbursimi i kontributeve të paguara tepër

Nëse shuma e kontributeve të paguara e tejkalon shumën e duhur, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Instituti i Sigurimeve Shëndetësore, sipas rastit, do të rimbursojë tepërcën brenda 30 ditësh nga zbulimi i mbipagesës ose njoftimi për këtë të fundit, duke paguar shumën në fjalë drejtpërdrejt ose duke e bartur atë për llogari të detyrimeve të ardhshme.

Bashkëngjitur janë:

Shtojca 1: Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore
E-SIG011/a

Shtojca 2: Formulari i deklarimit dhe pagesës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore
E-SIG012/a

Shtojca 3: Pasqyra e kontributeve për t'u paguar (Listpagesa) E-SIG025/a

Shtojca 4: Pasqyra e përfitimeve për t'u paguar E-SIG026/a

Shtojca 5: Pasqyra për të punësuarit rishtazi dhe të larguarit E-SIG027/a

Shtojca 6: Aplikimi për dorëzimin në format elektronik i të dhënave të punonjësve për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, formulari E-SIG086/a

Shtojca 7: Format i elektronik i të dhënave të punonjësve për kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale, formulari E-SIG046/a

MINISTRI I FINANCAVE
Kastriot Islami

**FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE KONTRIBUTEVE TE
SIGURIMEVE SHOQERORE**



[2] Periudha tatimore

[1] Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): [3] _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: [4] _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: [5] _____
Adresa: [6] _____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: [7] _____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperme eshte jo i plote ose ka ndryshuar

☐ Pa veprimtari

Perfitimet paguar Punemarresit	Shuma gjithsej (Lek)
E ardhura per semundje (Kodi 01)	9
E ardhura per kompensim semundje (kur ndryshon vendi i punes ose re- duktohen oret e punes) (Kodi 02)	10
Kompensim per barre lindje (Kodi 03)	11
Kompensim per barre lindje kur ndryshon vendi i punes (Kodi 04)	12
Grant per femije te lindur (Kodi 05)	13
Perfitim nga pensione invaliditeti te pjesshme (Kodi 06)	14
Pagesa ne raste vdekje (Kodi 07)	15
Kompensim per semundje per shkak aksidenti ne pune (Kodi 08)	16
Perfitim nga pensione invaliditeti nga aksidente ne pune dhe semundje profesionale (Kodi 09)	17
Perfitime nga pensione per ish- ushtaraket (Kodi 10)	18
Perfitimet Gjithsej	19

Kontributet per t'u Paguar	Shuma gjithsej (Lek)
Kontributet nga punedhenesi	20
Kontributet nga punemarresit (pa kontributet shitese)	21
Kontributet shitese	22
Kontributet gjithsej (20 + 21 + 22)	23
Perfitimet e paguara (nga kutiza 19)	24
Kontributet per tu paguar (23—24)	25

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperme eshte i plote dhe i sakte.

Vetem per perdorim zyrtar

PAGESA

☐ Leke

☐ Xhirim

☐ Cek

☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nep unesit te bankes

Originali - Zyra e Tatimeve
Kopja - Personi i Tatueshem

Numri i Formularit E-SIG 011/a

Shenimet e Formularit E-SIG 011/

Shenim1:	<i>Periudha Tatimore.</i> Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09
Shenim2:	<i>Numri Serial.</i> Kjo rubrike perdoret nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Shenim 3-7:	<i>Kutiza 3 — 7 Gjeneralitete.</i> Shenoni te dhenat e subjektit siç paraqiten ne formular dhe tregoni nese te dhenat e paraqitura nuk jane te plota ose kane ndryshuar. Emri i personit fizik kerkohet vetem nese subjekti i regjistruar nuk eshte shoqeri tregtare.
Shenim 8:	Nese per periudhen e deklarimit nuk ka patur veprimtari ekonomike dhe nuk keni dhene asnje pagese ose asnje perfitim asnjërit prej punemarresve tuaj, spontoni kutizen. Shenoni '0' ne kutizen 25. Nuk eshte e nevojshme te plotesoni ndonje kuti tjeter. Dorezoheni formularin ne banke.
Shenim 8a Punedhenesi:	Plotesoni kutizat 9—25 e me pas ky formular duhet te dergohen ne banke me pagesen per t'u bere jo me vone se data 25 e muajit vijues te muajit te deklarimit sebashku me formularet shoqerues te meposhtem: Formularin e deklarimit te kontributeve shendetesore E-SIG 012/a Formularin e deklarimit te tatimit mbi te ardhurat te mbajtur ne burim E-TAP 010/a Cdo tremujor ju duhet te dorezoni pasqyrat dhe formularet vijues drejteperdrejt ne degen e tatimeve deri ne daten 25 te muaji te dhene: Prill, Korrik, Tetor dhe Janar. Formularin (Pasqyren) e listepageses per sigurimet shoqerore E-SIG 025/a Formularin (Pasqyren) e perfitimeve te paguara E-SIG 026/a Formularin (Pasqyren) e punonjesve te punesuar rishtazi dhe atyre te larguar E-SIG 027/a Formulari i deklarimit te te dhenave E-SIG 046/a
Shenim 8b: Individet e regjistruar:	8.1. <i>I vetepunesuar pa punemarres.</i> Nese si individ, paguani sigurimeve shoqerore dhe shendetesore me nje kuote fikse, plotesoni vetem kutine 25, plotesoni gjithashtu Formularin E-SIG 012/a, 'Deklaraten e Kontributeve Shendetesore' sipas shenimeve ne ate formular, dhe me pas merrni te dy formularet e dergojini ne banke jo me vone se sa data 25 e muajit te fundit te periudhes tremujore (Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor) te vitit kalendarik. Nuk kerkohet ndonje pasqyre. 8.2. <i>I vetepunesuar me punemarres.</i> Nese ju paguani nje kontribut me kuote fikse te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore si individ, por ne veprimtarine tuaj ekonomike keni punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) ju duhet te dorezoni per punonjesit tuaj formularet dhe pasqyrat sic tregohet ne Shenimin 8a, por duke i shtuar gjithashtu te dhenat tuaja personale dhe kontributin tuaj me mase fikse per vete dhe per punonjesit e papaguar te familjes ne formularin E-SIG 025/a "Pasqyra e Pagesave te Sigurimeve Shoqerore" dhe dorezoheni sipas shenimeve te ketij formulari. 8.3. Nese ne veprimtarine ekonomike jeni punesuar personalisht dhe keni punesuar vetem punetore te papaguar te familjes, hidhni te dhenat personale dhe masen fikse te kontributit per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per t'u paguar per cdonjerin nga pjestaret e familjes perfshi veten tuaj ne formularin E-SIG 025/a 'Pasqyra e Pagesave te Sigurimeve Shoqerore' dhe dorezoheni kete listepagese sipas shenimeve te formularit. Ju gjithesesi do te plotesoni kete deklarate dhe formularin E-SIG 012/a 'Deklarata e kontributeve shendetesore' e me pas merrni te dy formularet dhe pasqyren dhe depozitojini ne banke jo me vone se dita e 25te e muajit te fundit te periudhes tremujore (Mars, Qershor, Shtator, Dhjetor) te vitit kalendarik.
Shenim 9-18	Shenoni shumen e seciles dege te perfitimit qe i eshte paguar punemarresit ne muajin e deklarimit sipas tipit te perfitimit.
Shenim 19:	Shenoni shumen e perfitimeve gjithsej qe u eshte paguar punemarresve (shuma e kutive 9 - 18).
Shenim 20:	<i>Kontributet nga punedhenesi.</i> Shënoni kontributet bruto te dhena nga punedhenesi.
Shenim 21:	<i>Kontributet nga punemarresi.</i> Shënoni kontributet bruto te dhena nga punemarrësi.
Shenim 22:	<i>Kontributet shtese.</i> Perdoret vetem per nepunesit shtetërore qe derdhin kontribute shtese per pensionet. Shënoni kontributet bruto te dhena nga punemarrësit.
Shenim 23:	<i>Kontributet ne total.</i> Shënoni shumën e kontributeve bruto të pagueshme (shuma e kutive 20 deri 22).
Shenim 24:	<i>Perfitimet e paguara.</i> Shënoni përfitimet e pagueshme gjithsej nga kutia 19.
Shenim 25:	<i>Kontributet per t'u paguar.</i> Shenoni kontributin e pagueshem neto (Kutiza 23 minus Kutizen 24), shënoni të njëjten shifër ne fletë-pagesë dhe paguani ne banke shumen e duhur.
Shënim 26:	Ky formular perdoret per te deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqerore. Duhet te perdoret se bashku me formularin e liste-pageses numer E-SIG 025/a, E-SIG 026/a dhe E-SIG 027/a qe permbajne pagesen, perfitimet dhe te dhena per te punesuarit rishtazi dhe te larguarit per cdo kontribues dhe formularin E-SIG 012/a 'Deklarimin e kontributeve shendetesore'. Udhezimet per plotesimin dhe dorezimin e liste-pagesave jane te shtypura ne liste-pagesa.

FORMULAR I DEKLARIMIT DHE
PAGESES SE KONTRIBUTEVE TE
SIGURIMEVE SHENDETESORE



[2] Periudha tatimore

[1] Numri Serial: _____

Numri i Vendosijes se Dokumentit (NVD)
(Vetem per perdorim zyrtar)

Numri Identifikues i Personit te Tatueshem (NIPT): [3] _____
Emri Tregtar i Personit te Tatueshem: [4] _____
Emri Mbiemri i Personit Fizik: [5] _____
Adresa: [6] _____
Qyteti/Komuna/Rrethi: _____
Numri Telefonit: [7] _____

Lajmeroni nese informacioni i mesiperm eshte jo i plote ose ka ndryshuar

☐

Pa veprimtari

Deklarim permbledhes

[A] Kontributet per tu paguar

Data dhe Firma e Personit te Tatueshem - Deklaroj nen pergjegjesine time qe informacioni i mesiperm eshte i plote dhe i sakte.

Vetem per perdorim zyrtar

PAGESA

- ☐ Leke
☐ Xhirim
☐ Cek
☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR:

Data , Vula e Bankes dhe nenshkrimi i nep unesit te bankes

Originali - Zyra e Tatimeve
Kopja - Personi i Tatueshem

Shenimet e Formularit E-SIG 012/a

- Shenim 1: *Periudha Tatimore.* Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09
- Shenim 2: *Numri Serial.* Kjo rubrike perdoret nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
- Shenim 3-7: *Kutiza 3 — 7 Gjeneralitete.* Shenoni te dhenat e subjektit siç paraqiten ne formular dhe tregoni nese te dhenat e paraqitura nuk jane te plota ose kane ndryshuar.
- Shenim 8: Nese per periudhen e deklarimit nuk ka patur veprimtari ekonomike dhe nuk keni dhene asnje pagese asnjërit prej punemarresve tuaj, spontoni kutizen. Shenoni '0' ne kutizen 9. Nuk eshte e nevojshme te plotesoni ndonje kuti tjeter. Dorezoheni formularin ne banke.
- Shenim 8a: Spontoni kutizen e kontributeve e me pas ky formular duhet te dergohen ne banke me pagesen per t'u bere jo me vone se data 25 e muajit vijues te muajit te deklarimit sebashku me formularet shoqerues te meposhtem:
Punedhenesit: Formularin e deklarimit te kontributeve shoqerore E-SIG 011/a
Formularin e deklarimit te tatimit mbi te ardhurat te mbajtur ne burim E-TAP 010/a
Cdo tremujor ju duhet te dorezoni pasqyrat dhe formularet vijues drejteperdrejt ne degen e tatimeve deri ne ditën e 25te te muajit te dhene: Prill, Korrik, Tetor dhe Janar.
Formularin (Pasqyren) e listepageses per sigurimet shoqerore E-SIG 025/a
Formularin (Pasqyren) e perfitimeve te paguara E-SIG 026/a
Formularin (Pasqyren) e punonjesve te punesuar rishtazi dhe atyre te larguar E-SIG 027/a
Formulari i deklarimit te te dhenave E-SIG 046/a
- Shenim 8b: **Individet e regjistruar:** 8.1. *I vetepunesuar pa punemarres.* Nese si individ, paguani sigurimeve shoqerore dhe shendetesore me nje kuote fikse, plotesoni vetem kutine 9, plotesoni gjithashtu Formularin E-SIG 011/a, 'Deklaraten e Kontributeve Shoqerore' sipas shenimeve ne ate formular, dhe me pas merrni te dy formularet e dergojini ne banke jo me vone se sa dita e 25te e muajit te fundit te periudhes tremujore (Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor) te vitit kalendarik. Nuk kerkohet ndonje pasqyre.
- 8.2. *I vetepunesuar me punemarres.* Nese ju paguani nje kontribut me kuote fikse te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore si individ, por ne veprimtarine tuaj ekonomike keni punemarres (me ose pa punonjes te papaguar te familjes) ju duhet te dorezoni per punonjesit tuaj formularet dhe pasqyrat sic tregohet ne Shenimin 8a, por duke i shtuar gjithashtu te dhenat tuaja personale dhe kontributin tuaj me mase fikse per vete dhe per punonjesit e papaguar te familjes per secilin tremujor ne formularin E-SIG 025/a "Pasqyra e Pagesave te Sigurimeve Shoqerore" sipas shenimeve te formularit.
- 8.3. Nese ne veprimtarine ekonomike jeni punesuar vete dhe keni punesuar vetem punetore te papaguar te familjes, hidhni te dhenat personale dhe masen fikse te kontributit per sigurimet shoqerore dhe shendetesore per t'u paguar per cdonjerin nga pjestaret e familjes perfshi veten tuaj ne formularin E-SIG 025/a 'Pasqyra e Pagesave te Sigurimeve Shoqerore' dhe dorezoheni kete te fundit ne perputhje me shenimet e ketij formulari. Ju duhet gjithesesi te plotesoni kete formular deklarimi dhe formularin E-SIG 011/a 'Deklarata e kontributeve shoqerore' e me pas merrni te dy formularet dhe pasqyren dhe depozitojini ne banke jo me vone se dita e 25te e muajit te fundit te periudhes tremujore (Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor) te vitit kalendarik.
- Shenim 9: Shenoni shumen e kontributeve te pagueshme; shenoni te njejten shume ne mandatin bankar dhe paguani shumen e kerkuar ne banke.
- Shenim 10: Ky formular perdoret per te deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shendetesore. Duhet te perdoret se bashku me formularin e liste-pageses numer E-SIG 025/a qe paraqet te dhenat per pagesen e çdo kontribuesi. Udhezimet per plotesimin dhe dorezimin e liste-pageses jane te shtypura ne liste-pagese.

NIPTi Emri i tatimpaguesit Periudha Tatimore (VVVV/MM) / Rrethi

[illegible]

Shenimet e Formularit E-SIG 025/a

Kutiza 1:	Nese ju plotesoni me shume se nje faqe shenoni numrin e faqes dhe numrin gjithsej te faqeve
Kutiza 2:	Shenoni numrin tuaj te NIPT-it dhe emrin e regjistruar ne degen e tatimeve
Kutiza 3:	Shenoni perioden tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09 ku shifra MM eshte muaji i listepageses. Per cdo muaj kalendarik duhet te dorezohet nje listepagese.
Kutiza 4:	Shenoni emrin e rrethit ku subjekti ushtron veprimtarine ekonomike. Nese veprimtaria ekonomike e juaj kryhet ne me teper se nje rreth, dorezoni nje pasqyre me vete per secilin rreth ku ushtroni veprimtari ekonomike.
Kolona 5:	Shenoni ne kete kolone numrin e sigurimeve shoqerore (NSSH) cdo punemarresi. Nese jeni i vetepunesuar, shihni Shenimin 1 me poshte.
Shenim 1: <i>Te Vetepunesuarit:</i>	- Nese po e plotesoni kete formular si person i vetepunesuar me punetore te paguuar te familjes por pa punemarres, kur kollonat 5, 6, 7, 14 dhe 15 kerkojne te dhenat e punemarresit, ne vend te tyre shenoni te dhenat tuaja dhe te dhenat e punetoreve te paguuar te familjes. - Lerini bosh kollonat 8, 9, 10, 11, 12, 13, 16 dhe 17. - Plotesoni kollonat 14 dhe 15 me shumen e kontributeve shoqerore dhe shendetore per t'u paguar.
Kolona 6:	Shenoni emrin e odo punemarresi kundrejt NSSH te cdo personi me te dhenat e mjaftueshme per te identifikuar personin.
Kolona 7:	Shenoni numrin e kategorise se punemarresve, kur nuk punojne me kohe te plote, si vijon: 1 - nuk kerkohet te vendoset 1 (numer i paracaktuar per punemarresit me kohe te plote; 2- gjithnje me kohe te pjesshme (me pak se 24 ore/jave); 3-i perkohshem (me pak se 1 jave gjate vitit); 4—punemarresit e tjere; 5-nuk perdoret; 6-punetori i paguuar i familjes; 7-nuk perdoret; 8-persona ne kurse dhe studente ne praktika mesimore.
Kolona 8:	Shenoni pagen gjithsej qe i keni dhene punemarresit (ose kuoten fikse nese perdoret per llogaritjen) gjate muajit dhe qe sherben si baze per llogaritjen e detyrimit te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe sigurimeve shendetore ne perputhje me kerkesat e VKM nr. 402, date 10.10.2002 (i amenduar). Per me shume sqarime, referojuni fletapalosjes shpjeguese.
Kolona 9:	Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore te paguar nga punedhenesi gjate muajit sipas pages se dhene cdo punemarresi. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e pasqyres duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit korrespondues.
Kolona 10:	Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore te mbajtur ne burim nga punedhenesi per punemarresin gjate muajit sipas pages se deklaruar per cdo punemarres. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e listepageses duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e per muajin korrespondues.
Kolona 11:	Shenoni kontributet shtese gjithsej te mbajtura ne burim gjate muajit. Mblidhni kolonen dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten tuaj per muajin korrespondues. (Kjo kollone eshte e zbatueshme vetem per nepunesit shteterore dhe zyrtaret.)
Kolona 12:	Shenoni kontributin bruto per t'u paguar per cdo punemarres = kollonat 9+10+11. Mblidhni shumen e kolones 12 dhe kaloni shumen ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne pasqyre duhet te jete e barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e muajit korrespondues.
Kolona 13:	Shenoni nga formulari numer E-SIG 026/a 'Lista e Përfitimëve të Dhëna' shumen gjithsej te perfitimeve qe i jane paguar nje punemarresi gjate muajit. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit korrespondues.
Kolona 14:	Shenoni kontributin e pagueshem neto per cdo punemarres = kollona 12 – kollona 13. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit korrespondues
Kolona 15:	Shenoni shumen gjithsej te kontributeve shendetore per cdo punemarres gjate muajit, duke u bazuar ne pagen e deklaruar [shih kollonen 8]. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit perkates.
Kolona 16:	Shenoni pagen bruto qe i keni paguar punemarresit (pa zbritjet si kontributet, tatimi) gjate muajit dhe qe eshte baza per llogaritjen e tatimit mbi te ardhurat personale. Kjo mund te ndryshoje nga paga e deklaruar per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetore. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit perkates.
Kolona 17:	Shenoni tatimin mbi te ardhurat personale te mbajtur ne burim nga paga e cdo punemarresi gjate muajit. Mblidhni shumen e kolones dhe kaloni totalin e shumes ne faqen tjeter ose shenoni shumen e pasqyres. Shuma e shenuar ne listepagese duhet te jete e barabarte me kontributet e pasqyruara ne deklaraten e muajit perkates.
Shënim 2:	Ky formular perdoret per te perfshire parate qe ju duhet t'u mbani ne burim punemarresve tuaj per te paguar perfitimet e percaktuara (kontributet e sigurimeve shoqerore dhe kontributet e sigurimeve shendetore) si dhe tatimin mbi te ardhurat personale te mbajtur ne burim.
Shënim 3:	Formulari duhet te perdoret se bashku me tre formularet e veçante te deklarates dhe pageses per tre pagesat e duhura – kontributet e sigurimeve shoqerore, kontributet e sigurimeve shendetore dhe tatimin mbi te ardhurat personale. Udhëzimet per plotesimin e deklaratave jane te shtypura ne cdo formular deklarate.
Shënim 4:	Punedhenes: Cdo tremujor ju duhet te dorezoni listepagesat dhe formularin e meposhtem drejteperdrejt ne degen e tatimeve deri ne ditën e 25te te muajit qe vijon tremujorin, p.sh. data 25 e: Prill, Korik, Tetor dhe Janar. Listepagesa e kontributeve dhe tatimit mbi te ardhurat E-SIG025/a; Listepagesa e perfitimeve te dhena E-SIG026/a; Pasqyra e te punesuarve nishtazi dhe te larguarve E-SIG027/a; Formulari i deklarimit te te dhenave E-SIG046/a. Ato mund te dorezohen ne format elektronik. Te vetepunesuar me punetore te paguuar te familjes: Cdo tremujor ju duhet te dorezoni kete listepagese dhe formularin e deklarimit te te dhenave drejteperdrejt ne degen e tatimeve deri ne ditën e 25te te muajit te fundit te tremujorit, p.sh. dita e 25te e: Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor.

Shenimet e Formularit E-SIG 026/a

- Kutiza 1:** Nese po plotësoni me shume se nje fage shenoni numrin e fages dhe numrin gjithsej te fageve
- Kutiza 2 & 3:** Shenoni numrin tuaj te NIPT-it dhe emrin e regjistruar ne degen e tatimeve
- Kutiza 4:** Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09, ku shifra MM eshte muaji te listepageses. Per cdo muaj kalendarik duhet te depozitohet nje listepagese.
- Kutiza 5:** Shenoni emrin e rethit ku subjekti ushtron veprimtari ekonomike. Nese veprimtaria ekonomike kryhet ne me teper se nje rreth, dorezoni nje pasqyre me vete per secilin rreth ku ushtron veprimtari ekonomike.
- Kolona 6:** Shenoni ne ketë kolone numrin e sigurimeve shogqerore (NSSH) per cdo punemarrtes
- Kolona 7:** Shenoni emrin e cdo punemarrtesi kundrejt NSSH-ne e punemarrtesi se bashku me te dhena te njefiteshme per identifikimin e personit.
- Kolona 8:** Shenoni numrin e kodit per perfitim e paguar sipas listes se paraqitur ne fagen e pare te ketij formulari. Perdorni nje kolone te vecante per cdo perfitim te paguar secilit person, deri ne kater maksimumi. Nese keni paguar ndonje punemarrtesi me teper se kater perfitime ne muaj, kontrakti per keshtillm degen e tatimeve.
- Kolona 9:** Shenoni në këtë kolonë shumën gjithsej të cdo perfitimi të paguar gjate muajit.
- Kolona 10:** Shenoni sipas rasis në këtë kolonë numrin e dieve gjate muajit kur eshte kerkuar perfitimi.
- Kolona 11:** Mblidhni shumën e perfitimeve per punemarrtes gjate muajit dhe pastaj kaloni shumën ne kolonën 13 te formularit korrespondues E-SIG 025/a të Sigurimeve Shogqerore, Sigurimeve Shendetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat të Mbjatur në Burim kundrejt informacionit perkates te cdo punemarrtesi.
- Shënim 1:** Ky formular perdoret per te perfshire cdo perfitim qe i keni paguar punemarrtesve tuaj, te cilat pastaj zbrithen nga pagesa e kontributeve te sigurimeve shogqerore.
- Shënim 2:** Ky formular duhet te perdoret se bashku me formularin numer E-SIG 025/a te deklarimit te kontributeve te sigurimeve shogqerore. Udhëzimet per plotësimin e deklarave jane te shtrypura ne formular.
- Shënim 3:** Cdo tremujor duhet te dorezoni listepagesat e meposthine dhe formularin drejtperdrejt ne degen e tatimeve ne ditën e 25te te muajit qe vijon pas tremujorit, p.sh. 25 Prill, Korrik, Tetor dhe Janar. Formulari i kontributeve dhe tatimit per t'u paguar E-SIG025/a. Listepagesa e perfitimeve te paguara E-SIG 026/a. Pasqyra e te punesuarve rishazi dhe te larguarve E-SIG027/a. Formulari i deklarimit te te dhenave E-SIG046/a. Keto listepagesa duhet te plotësohen nje here ne muaj (3 listepagesa per cdo tremujor). Ato mund te dorezohen me format elektronik.

Pasqyra e te Punesuarve Rishtazi dhe e te Largarve

1	Faqja _____ nga _____
---	-----------------------

NIPTi **2** Emri i tatimpaguesit **3** Periudha Tatimore (VVVV/MM) **4** / Rrethi **5**

[illegible]

Shenimet e Formularit E-SIG 027/a

Kutiza 1:	Nese po plotesoni me shume se nje faqe shenoni numrin e faqes dhe numrin gjithsej te faqeve
Kutiza 2 & 3:	Shenoni numrin tuaj te NIPT-it dhe emrin e regjistruar ne degen e tatimeve
Kutiza 4:	Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2003/09, ku shifra MM eshte muaji i fundit i muajit. Nese eshte rasti, pasqyra duhet te depozitohet cdo muaj.
Kutiza 5:	Shenoni emrin e rrethit ku subjekti ushtron veprimtarine ekonomike. Nese veprimtaria ekonomike kryhet ne me teper se nje rreth, dorezoni nje pasqyre me vete per secilin rreth ku ushtroni veprimtari ekonomike.
Kolona 6:	Shenoni ne kete kolone numrin e sigurimeve shoqerore (NSSH) per cdo kolone
Kolona 7:	Shenoni emrin e cdo punemarresi kundrejt NSSH-se ste punemarresit se bashku me te dhena te mjaftueshme per identifikimin e personit.
Kolona 8:	Shenoni sipas rastit daten e fillimit te punes te punonjesit te ri.
Kolona 9:	Shenoni sipas rastit daten e largimit te punonjesit.
Shënim 1:	Ky formular perdoret per te njoftuar degen e tatimeve per cdo punemarres qe punesohet apo largohet gjate muajit te deklarimit. Ju duhet te deklaroni vetem ato punemarres qe largohen apo punesohen gjate muajit te deklarimit.
Shënim 2:	Cdo tremujor duhet te dorezoni listepagesat e meposhtme dhe formularin drejteperdrejt ne degen e tatimeve ne ditën e 25te te muajit qe vijon pas tremujorit, p.sh. 25 Prill, Korrik, Tetor dhe Janar: Formulari i kontributeve dhe tatimit per t'u paguar E-SIG025/a; Listepagesa e perfitimeve te paguara E-SIG 026/a; Pasqyra e te punesuarve rishtazi dhe te larguarve E-SIG027/a; Formulari i deklarimit te te dhenave E-SIG046/a; Keto listepagesa duhet te plotesohen nje here ne muaj (3 listepagesa per cdo tremujor). Ato mund te dorezohen me format elektronik.

Formulari E-SIG046/a

PASQYRE DEKLARIMI ME TË DHËNAT PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE TË SIGURIMEVE SHOQËRORE, SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE

NIPT-i:

1.

Emri i subjektit:

2.

Adresa e subjektit:

Rruga
Qyteti
Rrethi

3.

Telefoni i zyrës:

4.

Email:

5.

Emri i kontaktit dhe numri i telefonit: *Shih shënimin 1*

6.

Shënim 1: Personi i kontaktit i dhënë duhet të jetë një person që është në gjendje të përgjigjet për çdo pyetje që lidhet nga të dhënat e dorëzuara

Numri i autorizimit:

7.

8. Deklaratë

Unë deklaroj:

Pasqyrat me të dhëna të dërguara me këtë formular janë të dhënat e kërkuara sipas Ligjit nr. 9136 datë 11.9.03 Nenet 10 dhe 11 dhe përbëjnë pjesë të deklarimit për Sigurimet Shoqërore, Sigurimet Shëndetësore and Tatimit mbi të Ardhurat Personale të dorëzuar për periudhën tatimore ne fund te tremujorit

[muaji _____] [Viti _____];

Në rastet e dorëzimit në format elektronik, të dhënat përputhen me "Kushtet për dorëzimin elektronik të të dhënave për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale";

E kuptoj që dorëzimi i të dhënave në format elektronik është një deklaram i përcaktuar në Ligjin nr. 9136 datë 11.9.03 Neni 10 dhe se për nga pikëpamja e gjobave dhe interesave, këto të dhëna do të trajtohen njëjloj si dhe ato të dorëzuara në letër.

Kjo pasqyrë është një pasqyrë [origjinale/e ndryshuar]* *fshij sipas rastit

Nënshkrimi dhe data:

Nënshkrimi

Datë

Emri i plotë me gërma SHTYPI dhe pozicioni ose statusi:

Emri

Statusi

Për përdorim zyrtar [E zbatueshme vetëm për të dhënat në format elektronik]**

Marrë	Datë	Nënshkrimi
Kontrrolli për viruset**		
Kontrrolli i formatit**		
Marrja e të dhënave		

Formulari E-SIG086/a**KËRKESË PËR DORËZIMIN NË FORMAT ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE PËR KONTRIBUTET E SIGURIMEVE SHOQËRORE, SIGURIMEVE SHËNDETËSORE DHE TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE**

NIPT-i:

1.

Emri i subjektit:

2.

Adresa e
subjektit: *Rruga*
Qyteti
Rrethi

3.

Telefoni i zyrës:

4.

Email:

5.

Emri i kontaktit dhe numri i
telefonit: *Shih shënimin 1*

6.

Shënim 1: Personi i kontaktit i dhënë duhet të jetë një person që është në gjendje të përgjigjet për çdo pyetje që lidhet nga të dhënat e dorëzuara

7.

Deklaratë

Unë deklaroj:

Kam lexuar "Kushtet për dorëzimin në format elektronik të të dhënave për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale";

Unë pajtohem me këto kushte;

E kuptoj që dorëzimi i të dhënave në format elektronik është një deklaram i përcaktuar në Ligjin nr. 9136 datë 11.9.03 Neni 10 dhe se për nga pikëpamja e gjobave dhe interesave, këto të dhëna do të trajtohen njëjloj si dhe ato të dorëzuara në letër.

Nënshkrimi dhe data:

*Nënshkrimi**Datë*Emri i plotë me gërma
SHTYPI dhe pozicioni ose
statusi:*Emri**Statusi*

Për përdorim zyrtar	Marrë	Datë
Data e mbërritjes		
Verifikimi i NIPT-it		
Testimi i mostrës së përdorur për transferim	I Kënaqshëm / Jo i kënaqshëm*	
Dhënia/Refuzimi i Autorizimit*		
Numri i autorizimit		

*Fshini sipas rastit

KUSHTET PËR DORËZIMIN ELEKTRONIK TË TË DHËNAVE PËR SIGURIMET SHOQËRORE, SIGURIMET SHËNDETËSORE DHE TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE

Kushtet e përgjithshme

1. Formulari i deklarimit dhe pagesës duhet të dorëzohet në bankë sipas procedurës së zakonshme.
2. Dorëzimi i elektronik i të dhënave duhet të bëhet sipas formatit të përcaktuar në Aneksin A ose B. Nëse nuk e bëni një gjë të tillë, deklarata do të konsiderohet si jo e kryer dhe ju do të paguani gjobat që parashikohen për mosdorëzim të dhënash. Të dhënat duhet të shoqërohen nga një deklaratë e vetme (duke përdorur Formularin E-SIG046/a) që informacioni i përmbajtur në skedarin përkatës nuk është i plotë dhe i pasaktë.
3. Të dhënat elektronike duhet të dorëzohen në degën e tatimeve që merret me çështjet tuaja tatimore jo më vonë se data e përcaktuar për dorëzimin e deklaratës në letër. Ashtu sikurse të dhënat e punëmarrësit përbëjnë një kërkesë ligjore e deklaratës, mosdorëzimi i të dhënave në kohë do të thotë që deklarata është e vonuar.

Mjeti i shkëmbimit

4. Të dhënat duhet të dorëzohen në një disketë 1.4MB të formatuar në Microsoft Windows®- ose një CD-ROM që mund të lexohet duke përdorur Microsoft Windows®.
5. Mjeti i shkëmbimit duhet të etiketohet me emrin dhe NIPT-in e punëdhënësit dhe për periudhën e deklarimit (tremujore) për të cilën janë paraqitur këto të dhëna.

Formati

6. Të dhënat duhet të dorëzohen si skedar tekst që përmban një regjistrim Titull ku përcaktohen informacioni i kontributeve për çdo punonjës dhe rreshtat e të dhënave ku jepet informacioni për kontributet e kërkuara për secilin punëmarrës si dhe rreshtat me të dhëna ku jepen përfitimet e paguara. Skedari duhet të jetë i formatuar në përputhje me përcaktimin e shkëmbimit të të dhënave në Aneksin A ose me skemën XML në Aneksin B.
7. Përpara se të japim miratimin për dorëzimin elektronik të të dhënave, për qëllimet e testimit dhe vlerësimi duhet të dorëzohet një mostër të dhënash në DPT.

Për përdorim nga zyra	Emri	Data	Nënshkruar
Testi i të dhënave i përfunduar me sukses:			
Përdorimet e miratuara nga:			

Aneksi A: Përcaktimi i Shkëmbimit të të Dhënave

TITULLI I DEKLARATËS (Për çdo punëmarrës)

Elementi të Dhëna	Pozicioni			
	Gjatësia	Nga	Për	D / Z
Treguesi i Elementit = TITULLI	6	1	6	D
NSSH (NI Kombëtar)	10	7	16	D
Emri i Punëmarrësit	20	17	36	D
Paga për Kontributet	15	37	51	D
Kontributet Gjithsej të Punëdhënësit	15	52	66	D
Kontributet Gjithsej të Punëmarrësit	15	67	81	D
Kontributet Bruto	15	82	96	D
Përfitimet Gjithsej të Paguara	15	97	111	D
Kontributet Neto	15	112	126	D
Data e Fillimit (DD/MM/VVVV)	10	127	136	Z
Data e Largimit (DD/MM/VVVV)	10	137	146	Z
Kontributet Shëndetësore	15	147	161	D
Tatimi mbi të Ardhurat Personale	15	162	176	D
Periudha Tatimore (VVV/MM)	11	177	187	D
NIPT-i i Punëdhënësit	10	188	197	D
Kontributet Shtesë	15	198	212	Z
Paga e Tatueshme	15	213	227	D
Kodi NACE (Sipas NIPT-it)	5	228	232	Z
Kodi i Kategorise (1-8)	1	233	234	D
Rrethi	2	235	236	C

TË DHËNAT E DEKLARIMIT (Për çdo përfitim për secilin punëmarrës)

Elementi të Dhëna	Pozicioni			
	Gjatësia	Nga	Për	D / Z
Treguesi i Elementit = TË DHËNA	6	1	6	D
NSSH	10	7	16	D
Kodi i Përfitimit	2	17	18	D
Shuma	15	19	33	D
Ditë	2	34	35	D
Periudha Tatimore (VVV/MM)	11	36	46	D

Legjenda

D=e Detyrueshme, Z= me Zgjedhje

Përfitimeve të mbajtura në burim dhe të paguara punëmarrësit duhet t'u caktohet një kod si vijon:

01 E ardhura per semundje

02 E ardhura per kompensim semundje (kur ndryshon vendi i punes ose reduktohen oret e punes)

03 Kompensim per barre lindje

04 Kompensim per barre lindje kur ndryshon vendi i punes

05 Grant per femije te lindur

06 Perfitim nga pensione invaliditeti të pjesshme

07 Pagesa ne raste vdekje

08 Kompensim per semundje per shkak aksidenti ne pune

09 Perfitim nga pensione invaliditeti nga

aksidente ne pune e semundje profesionale **10** Perfitime nga pensione per ish-ushtaraket

Aneksi B: Skema XML

```
<?xml version ="1.0">
<!ELEMENT DECLARATION (#PCDATA)>
<!ELEMENT HEADER(NI_Kombetar, Emri, Paga_per_Kontribute, Kontributi_i_Punedhenesit,
Kontributi_i_Punemarresit, Kontributi_Bruto, Perfitimet, Kontributi_Neto, Data_e_Fillimit,
Data_e_Largimit, Sigurimet_Shendetesore, Tatimi_mbi_te_Ardhurat, Periudha_Tatimore,
NIPT_i_Punedhenesit, Kontribut_Shtese, Paga_e_Tatueshme, NACE, Kategoria, Rrethi)>
<!ELEMENT NI_Kombetar (#PCDATA)>
<!ELEMENT Emri (#PCDATA)>
<!ELEMENT Paga_per_Kontribute (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_i_Punedhenesit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_i_Punemarresit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_Bruto (#PCDATA)>
<!ELEMENT Perfitimet (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontributi_Neto (#PCDATA)>
<!ELEMENT Data_e_Fillimit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Data_e_Largimit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Sigurimet_Shendetesore (#PCDATA)>
<!ELEMENT Tatimi_mbi_te_Ardhurat (#PCDATA)>
<!ELEMENT Periudha_Tatimore (#PCDATA)>
<!ELEMENT NIPT_i_Punedhenesit (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kontribut_Shtese(#PCDATA)>
<!ELEMENT Paga_e_Tatueshme (#PCDATA)>
<!ELEMENT NACE (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kategoria (#PCDATA)>
<!ELEMENT Rrethi (#PCDATA)>
<!ELEMENT DETAIL (NI_Kombetar, Kodi, Shuma, Dita, Periudha_Tatimore)>
<!ELEMENT NI_Kombetar (#PCDATA)>
<!ELEMENT Kodi (#PCDATA)>
<!ELEMENT Shuma (#PCDATA)>
<!ELEMENT Dita (#PCDATA)>
<!ELEMENT Periudha_Tatimore(#PCDATA)>
```

**FORMULARI I VLERESIMIT TE
SIGURIMEVE SHOQERORE/
SHENDETESORE/TATIMIT MBI TE
ARDHURAT PERSONALE**

Numri i Vendorsjes se Dokumentit (NVD)



Periudha Tatimore

Numri i Vleresimit

Numri Serial

Numri i Identifikimit te Personit te Tatueshem (NIPT):

Emri Tregtar i Personit te Tatueshem:

Emri dhe Mbiemri i Personit Fizik:

Adresa:

Qyteti/Komuna/Rrethi:

Arsyeja e vleresimit:

	Kontributet ose Perfitimet e Deklaruara te Paguara	Kontributi per t'u Paguar ose Perfitimet e Paguara Faktikisht	Pagesa qe duhet bere
Kontrib. SSH te Punedhenesit			
Kontrib. SSH te Punemarresit			
Kontributet Shtese te SSH			
Kontributet gjithsej per t'u paguar			
Perfitimet e SSH te paguara			
Kontributet shendetesore			
Tatimi mbi te ardhurat personale			
Detyrimi gjithsej per t'u paguar			
Gjoha gjithsej per t'u paguar			
Interesi gjithsej per t'u paguar			
SHUMA GJITHSEJ PER T'U PAGUAR			
AFATI			

Pagesa e shumes se plote duhet te kryhet perpara ose ne daten e treguar me lart. Cdo vonese ne pagese mund te coje ne masa te renda, perfshi konfiskimin e mundshem te pasurise ose mbylljen e veprimtarise nga organi tatimor. Per me teper, shumes se vleresuar mund t'i shtohen gjoha dhe/ose interesa shtese.

Inspektori i vleresimit:

Data e vleresimit:

Per perdorim nga zyra

PAGESA

☐ Lek

☐ Xhirim

☐ Cek

☐ Te tjera:.....

SHUMA E PAGUAR

Data, Vula e Bankes dhe nenshkrimi i punonjesit te bankes

Originali - Dega e Tatimeve
Kopja - Personi i Tatueshem

Formulari numer E-SIG030/a

	<u>Shenimet per Formularin E-SIG030/a</u>
Shenimi 1:	Per cdo periudhe deklarimi dhe per cdo lloj tatimi apo kontributi, behet nje vleresim i vecante. Periudha tatimore e ketij vleresimi shenohet ne kutine "Periudha Tatimore". Tipi i tatimit shenohet ne te dhenat e vleresimit.
Shenimi 2:	Arsyeja e vleresimit jepet ne "Kutine e arsyes se vleresimit".
Shenimi 3:	Kur vleresimi nuk paguhet ne daten e duhur, shumes per t'u paguar i shtohen interesa shtese.
Shenimi 4:	Kur vleresimi behet per shkak te pretendimit per pagese me te larte te perfitimeve, ne kutine e shumes per t'u paguar do te shenohet shuma qe eshte kerkuar me teper.
Shenimi 5: <i>Apelimet</i>	Ju keni te drejte te apeloni kundrejt ketij vleresimi neqoftese e gjykoni te pasakte. Per te apeluar ju duhet te dorezoni nje njoftim me shkrim ne Degen e Tatimeve qe merret me ceshtjet tuaja tatimore brenda 30 ditesh nga marrja e njoftimit. Ne apelimin tuaj duhet te perfshihet periudha tatimore perkatese, shuma e detyrimit tatimor qe diskutohet dhe cdo e dhene tjeter te cilen e gjykoni si te pershtatshme. Nese deshironi te hidhni poshte kete vleresim, apelimit tuaj duhet t'i bashkelidhni nje kopje te vleresimit. Dega e Tatimeve do te nxjerre nje vendim brenda 30 ditesh nga dorezimi i apelimit. Nese nuk jeni te kenaqur me vendimin, ju mund te apeloni prane Komisionit Tatimor te Apelimit dhe Gjykates. Sidoqofte, apelimi nuk mund te shqyrtohet ne nje shkalle me te larte te hierarkise apeluese pa u shqyrtuar me pare ne nje shkalle me te ulet. Ju lutemi te vini re se shqyrtimi i apelimit tatimor nuk kufizohet ne ceshtjet subjekt i apelimit dhe Organi Tatimor mund te shqyrtoje te gjitha ceshtjet tatimore. Ju keni te drejte te jeni i pranishem per te shpjeguar te gjitha ceshtjet qe lidhen me apelimin tuaj. Sidoqofte, ju nuk mund ta terhiqni apelimin tatimor pasi jane sjelle fakte qe tregojne se shuma e detyrimit tatimor te vleresuar nuk ka qene e mjaftueshme. Ju keni te drejten te analizoni dokumentacionin mbi te cilin mbeshetet ky vleresim, me perjashtim te rasteve kur este e nevojshme te ruhet sekret per interesa publike apo private, sic jane sekretet e biznesit apo te nje pale te trete, ose identiteti i nje informatori. Refuzimet e nje analizimi kerkojne nje vendim ekzekutiv te posacem nga Drejtori i Pergjithshem i Tatimeve.
Shenim 6:	Ky vleresim duhet te paguhet ne cilendo nga bankat qe kane nje marreveshje per veprimin si agent per Organin Tatimor ne lidhje me mbledhjen e tatimeve. Kjo mund te jete banka ku ju paguani tatimet e deklaruar ose nje banke tjeter. Nje liste te bankave te zgjedhshme mund ta gjeni prane Deges se Tatimeve.

PËR MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONAT E LIDHUR ME TË

Baza ligjore dhe qëllimi

Neni 1

1.1 Baza ligjore e kësaj rregulloreje janë ligji nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” dhe ligji nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

1.2 Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve të bankës dhe degës së bankës së huaj me personat e lidhur me to.

1.3 Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat për thjeshtësi do t’i quajmë “bankë”.

Përcaktimet

Neni 2

2.1 Me persona të lidhur kuptojmë dy ose më shumë individë dhe/ose persona fizikë dhe/ose persona juridikë, të cilët mund të jenë rezidentë ose jorezidentë në Republikën e Shqipërisë, që për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje:

2.1.1 Plotësojnë kuptimin e termave të nenit 2 gërmat f dhe germa k të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, kur personi:

- ka pjesëmarrje në kapitalin e bankës ose në kapitalin e një shoqërie tjetër, e cila është aksionere e bankës;

- ndikon në vendimmarrjen e bankës apo të shoqërisë tjetër aksionere të bankës,

- është zotërues direkt ose indirekt i një pjese të kapitalit që i jep atij 25 për qind ose më shumë të votave të organit më të lartë vendimmarrës të bankës ose të personit tjetër juridik;

- i vetëm, ka në dispozicion shumicën e votave në bankë ose të personit tjetër juridik, në bazë të një marrëveshjeje të përfunduar me ortakët ose me aksionerët e tjerë;

- përcakton, *de facto* nëpërmjet të drejtës së votës që zotëron, vendimet e marra në mbledhjet e organit më të lartë të bankës ose të personit tjetër juridik, përfshirë dhe zgjedhjen dhe emërimin e administratorëve të bankës.

2.1.2 Janë administratorë të bankës, në përputhje me përcaktimet e bëra në rregulloren “Për administratorë të bankës dhe të degës së bankës së huaj”, dhe familjarët e tyre.

Në zbatim të nenit 35 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me termin familjarë kuptojmë:

- bashkëshorti (a) dhe fëmijët;

- të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve a të motrave.

2.1.3 Sipas vlerësimit me shkrim të inspektorëve të mbikëqyrjes, janë financiarisht të lidhur, në mënyrë të tillë që vështirësitë financiare të njërit shkaktojnë vështirësi financiare të të tjerëve.

2.1.4 Për zbatimin e kuadrit rregullativ të mbikëqyrjes, personat e lidhur konsiderohen si një kundërparti e vetme. Koeficienti i ponderimit për personat e lidhur njehsohet me koeficientin më të madh të ponderimit kur të paktën dy nga përbërësit e personave të lidhur kanë secili koeficientë të ndryshëm ponderimi.

2.2 Veprimet e bankës me personat e lidhur me të janë të gjitha veprimtaritë e lejuara të bankës, të kryera me personat e lidhur, të përcaktuara në pikën 2.1 të këtij neni.

Veprimet me personat e lidhur trajtohen nga banka, me të njëjtat terma dhe me të njëjtat kushte si veprimet me të gjithë klientët e tjerët të bankës.

2.3 Të drejtat ndaj personave të lidhur janë pjesë e veprimeve të bankës me personat e lidhur, në llogaritë e bilancit (kryegjë dhe interes) dhe/ose në llogaritë e jashtë bilancit të marra së bashku.

2.4 Të drejtat neto janë të drejtat ndaj personave të lidhur kur nga ato zbriten sipas radhës:

- i) fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga të drejtat për secilën prej llogarive të bilancit dhe/ose të llogarive jashtë bilancit;

- ii) garancitë dhe/ose kolaterali i marrë, kur këto garanci ose kolaterale plotësojnë kushtet e përcaktuara në rregulloren “Për kontrollin e risqeve të mëdha”.

2.5 Të drejtat në rrezik janë të drejtat neto të ponderuara me koeficientët, të përcaktuara në

rregulloren “Për mjaftueshmërinë e kapitalit” dhe në përputhje me pikën 2.1.4 të këtij neni.

Kërkesat mbikëqyrëse

Neni 3

3.1 Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 37 të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, përcakton kufizime për veprimet e bankës me personat e lidhur me të.

3.2. Për personat e lidhur të bankës që zotërojnë direkt dhe/ose indirekt jo më pak se 5 për qind të kapitalit të bankës, dhe/ose për personat sipas përcaktimit 2.1.2 dhe/ose 2.1.3 të nenit 2 të kësaj rregulloreje:

- i) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 20 për qind të kapitalit rregullator;
- ii) të drejtat në rrezik të jenë jo më të mëdha se 30 për qind të kapitalit rregullator kur personi i lidhur është një bankë;
- iii) totali i të drejtave në rrezik të jetë jo më i madh se 300 për qind e kapitalit rregullator.

Kontrolli

Neni 4

4.1 Organet vendimmarrëse të bankës miratojnë rregulla dhe udhëzime të brendshme për:

- i) drejtimin e rrezikut të veprimeve me personat e lidhur;
- ii) politikat dhe procedurat për dhënien e kredive, në të cilat të theksohet shprehimisht se kushtet e kredive për personat e lidhur janë të njëjta me kushtet e të gjithë klientelës.

4.2 Subjektet e kësaj rregulloreje të sigurojnë një sistem monitorimi dhe informacioni të vazhdueshëm për veprimet me personat e lidhur. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të mbikëqyrë në çdo kohë sistemin e monitorimit dhe të informacionit të veprimeve me personat e lidhur.

Raportimi

Neni 5

5.1 Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë në Bankën e Shqipërisë për veprimet me personat e lidhur sipas formatit të raportimit bashkëlidhur.

5.2 Formularët e raportimit, nga subjektet e kësaj rregulloreje, plotësohen çdo muaj, ndërsa raportimi në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Mbikëqyrjes, në sektorin e inspektimeve në vend, të bëhet më vonë se 10 ditë nga fundi i çdo tremujori. Inspektorët e Departamentit të Mbikëqyrjes kanë të drejtë të përcaktojnë afate më të shpeshta raportimi, kur e gjykojnë të arsyeshme.

Përfundimtare

Neni 6

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr.100, datë 10.12.2003 të Këshillit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

FORMULARI NR.1 **MARRËDHËNIET E BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR**

Emri i bankës.....

Periudha raportuese.....

Data e raportimit.....

Përgatiti (Emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (Emër, mbiemër, firmë)

Përbërja	Të drejtat (1)	Detyrimet (2)	Veprimet jashë – bilancit (të dhëna) (3)	Veprimet jashtë- bilancit (të marra) (4)
a. Individ: -----				
b. Person fizik: -----				
c. Person juridik: -----				
1. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////		
a. Individ: -----				
b. Person fizik: -----				
c. Person juridik: -----				
2. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////		

a. Individ -----				
b. Person fizik: -----				
c. Person juridik: -----				
n. Veprimet me personin e lidhur (a+b+c)	//////////	//////////		
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+..+n)	//////////	//////////		

FORMULARI NR.2
KËRKESAT MBIKËQYRËSE TË VEPRIMEVE TË BANKËS ME PERSONIN E LIDHUR

Emri i bankës.....

Periudha raportuese.....

Data e raportimit.....

Përgatiti (Emër, mbiemër, firmë)

Drejtuesi (Emër, mbiemër, firmë)

Kapitali rregullator	Shumat
(20%) e kapitalit rregullator:	////////////////////
(30%) e kapitalit rregullator:	////////////////////
(300%) e kapitalit rregullator:	////////////////////

Veprimet me personat e lidhur	Të drejtat (1) ¹	Fondet rezervë (2)	Garancitë dhe/ose kolaterale të marra (3)	Të drejtat neto (4) = (1) - {(2) + (3)}	Ponderimi (5)	Të drejtat në rrezik (6)=(4)*(5)
1. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
2. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
n. Veprimet me personin e lidhur (nga formulari nr.1)						
Totali i veprimeve me personat e lidhur (1+2+...+n)						

¹ Në këtë kolonë regjistrohen shuma e të dhënave të kolonës 1 dhe të dhënat e kolonës 3 (për zërat jashtë bilanci), të nxjerra nga formulari nr.1.

**PËR DISA NDRYSHIME
NË RREGULLOREN “PËR VEPRIMTARINË VALUTORE”,
MIRATUAR ME VENDIM NR. 64, DATË 30.7.2003
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në udhëzimin 1 të rregullores “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendim nr.64, datë 30.7.2003 të Këshillit Mbikëqyrës, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1.1 germa b ndryshohet si vijon: “fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës”.

2. Pika 2.1 germa b ndryshohet si vijon: “fatura përkatëse e subjektit-ose një dokument, i cili vërteton qëllimin për të cilin kërkohet kryerja e transfertës, dhe/ose kontrata dhe/ose marrëveshja përkatëse”.

3. Pika 2.1 germa c shfuqizohet.

4. Pika 1.1 germa c1 ndryshohet si vijon: “në rastet e pagesës së pjesshme të shumës totale, në përputhje me kushtet e kontratës, afati maksimal i paraqitjes së aktit të zhdoganimit të mallit të paguar është deri në tre muaj pas kryerjes së pagesës. Me kalimin e këtij afati nuk do të kryhet pagesa e radhës për këtë mall deri në paraqitjen e aktit të zhdoganimit të mallit të paguar. Përfundim bëjnë rastet kur afati i livrimit të mallit ose i kryerjes së shërbimit është përcaktuar ndryshe në kontratë, por jo më shumë se 12 muaj.”

5. Pika 1 “Transferrat për veprimet tregtare për mallrat” shtohet pika 1.5 me këtë përmbajtje:

“ 1.5 Kur pagesa kryhet paradhënie ose para mbërritjes së mallit në Republikën e Shqipërisë për shumat deri në 3.5 milionë lekë ose ekuivalenten e saj në monedhë të huaj të llogaritur me kursin e ditës së kryerjes së pagesës:

a) Kërkesa për kryerjen e veprimit, ku jepet përshkrimi i natyrës dhe i qëllimit për të cilin kryhet, nënshkruar nga vetë kërkuesi. Po në këtë kërkesë, subjekti të deklarojë se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera.

b) Akti i zhdoganimit të mallit sipas rasteve të parashikuara në pikën 1.1. germa c.”

6. Këto ndryshime u miratuan me vendimin nr.101, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë që hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI
Shkëlqim Cani**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN
“PËR EKSPERTËT KONTABËL TË AUTORIZUAR TË BANKAVE”,
MIRATUAR ME VENDIMIN NR.6, DATË 29.1.2003
TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

Në rregulloren “Për ekspertët kontabël të autorizuar të bankave”, miratuar me vendimin nr. 6, datë 29.1.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 1 shtohet pika 1.5 me këtë përmbajtje:

1.5 Komiteti i kontrollit të bankës, në bazë të procedurave me shkrim të përgatitura nga banka, bën përzgjedhjen dhe i propozon asamblesë së aksionerëve ekspertin kontabël të autorizuar.

Komiteti i kontrollit bën vlerësimin e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Në nenin 2 ndryshohet pika 2.3 paragrafi i fundit, me këtë përmbajtje:

Vërtetimin nga autoriteti licencues që vërteton se shoqëria e ekspertëve kontabël të autorizuar ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël ose shoqëria ndërkombëtare e auditimit, me të cilën shoqëria e auditimit e krijuar në Shqipëri, e zotëruar (filiale) dhe e kontraktuar prej saj, ka jo më pak se 5 vjet eksperiencë në fushën e ekspertizës kontabël.

3. Në nenin 3 ndryshon pika 3.3 dhe shtohen pikat 3.4 dhe 3.5 me këtë përmbajtje:

3.3 Miratimi i emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar bëhet nga Drejtori i Departamentit të Mbikëqyrjes. Refuzimi i emërimit të ekspertit kontabël bëhet nga administratori përgjegjës për

Departamentin e Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë.

3.4 Refuzimi i ekspertit kontabël të autorizuar ndodh edhe në rastin kur Banka e Shqipërisë gjykon se eksperti kontabël i autorizuar, në auditimin e mëparshëm, nuk ka vepruar në përputhje me ose nuk ka plotësuar në mënyrë të mjaftueshme kërkesat e nenit 4, të nenit 5 pika 5.1, të nenit 6 pikat 6.1 deri në 6.4 dhe të nenit 7 të kësaj rregulloreje.

3.5 Eksperti kontabël i autorizuar dhe/ose banka, në rast refuzimi, kanë të drejtën e ankimimit në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë është përfundimtar.

4. Në nenin 4 ndryshon pika 4.2 me këtë përmbajtje:

4.2 Kontrolli i raporteve financiare, sipas pikës 4.1 të këtij neni, kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit).

5. Në nenin 5 ndryshon pika 5.1 me këtë përmbajtje:

5.1 Në bazë të kontrollit që u ka bërë raporteve financiare për vitin ushtrimor, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin përkatës mbi këtë kontroll, të ushtruar në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontrollit (auditimit) dhe ia dorëzon këtë raport drejtuesve të bankës dhe komitetit të kontrollit.

6. Në nenin 6 ndryshon pika 6.4 me këtë përmbajtje:

6.4 Eksperti kontabël i autorizuar dorëzon vlerësimin e tij me shkrim tek drejtuesit e bankës dhe te komiteti i kontrollit për pasqyrat financiare të përcaktuara në këtë nen.

7. Në nenin 7 ndryshon pika 7.2 dhe shtohet pika 7.3 me këtë përmbajtje:

7.2 Eksperti kontabël i autorizuar kërkon paraprakisht dhe vlerëson shqetësimet e Bankës së Shqipërisë për aspekte të veçanta të veprimtarisë së bankës.

7.3 Eksperti kontabël i autorizuar përgatit një raport, në të cilin shpreh opinionin dhe vlerësimin e tij mbi rezultatet e nxjerra për organizimin dhe për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të bankës mbi cilësinë e rregulloreve të bankës dhe zbatimin e tyre, të cilin e dorëzon tek drejtuesit e bankës, te komiteti i kontrollit dhe një kopje të tij edhe në Bankën e Shqipërisë, jo më vonë se 6 muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

8. Në nenin 8 ndryshojnë pikat 8.2 dhe 8.3 me këtë përmbajtje:

8.2 Sipas kërkesës së bërë nga Banka e Shqipërisë, drejtuesit e bankës paraqesin për dijeni në Bankën e Shqipërisë “letrën për administratorët”, që eksperti kontabël përgatit për drejtuesit e lartë të bankës. Lëshimi i “letrës për administratorët” është pjesë e letrës së angazhimit.

8.3 Një kopje e raporteve të ekspertit kontabël të autorizuar, të përgatitura sipas kërkesave të neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, së bashku me vlerësimet e komitetit të kontrollit, i dërgohen Bankës së Shqipërisë nga drejtuesit e bankës, jo më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të periudhës raportuese.

9. Këto ndryshime u miratuan me vendimin nr.102, datë 10.12.2003 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, që hyjnë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

KËRKESË

Shtetësja Eleni Allamani kërkon të shpallen të vdekur burri dhe vajza e saj Bajron dhe Esmeralda Allamani.

KËRKUESE
Eleni Tallamani

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI TETOR 2003

1.	KUSHTETUTA	600
2.	PËRMBLEDHËSE NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
4.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
5.	KODI PENAL	400
6.	KODI I PUNËS	500
7.	KODI I FAMILJES	450
8.	KODI CIVIL	1000
9.	KODI RRUGOR	900
10.	KODI ZGJEDHOR	355
11.	PËRMBLEDHËSE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT DOGANOR	1500
13.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

Doli nga shtypi më 16.12.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja Ideart
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë